

PROJEKTI PËR ZHVILLIM PROFESIONAL DHE NË KARRIERË TË ARSIMTARËVE

PËRMBAJTJE

Hyrje 2

Kompetenca profesionale
të arsimtarëve – pse u janë
ato të rëndësishme
arsimtarëve 3

Kompetenca dhe standarde
profesionale për
bashkëpunëtorë
profesional – nga këndi
personal 6

Për herë të parë te ne
– Kompetenca profesionale
për drejtorë 8

Reflektime të kompetencave
për zhvillim profesional dhe
në karrierë të arsimtarëve
në arsimimin inicial
të arsimtarëve 9

Pilotimi i proceseve
dhe instrumenteve
për zhvillim profesional
në SHFK “Maңu Matak”
- Krivogashtan 11

BULETINI numër 3 dhjetor 2015

Projekti i USAID-it për Zhvillim Profesional dhe në Karrierë të Arsimtarëve është financuar nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-së (USAID), ndërsa e realizon Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), në bashkëpunim me Fondacionin për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore Hap pas Hapi, e cila është përfshirë në aktivitetet lidhur me përpilimin e standardeve dhe kompetencave për arsimtarë.

Qëllimi i projektit është që të sendërtojë dhe përmirësojë sistemin për zhvillim profesional dhe në karrierë të arsimtarëve dhe në këtë mënyrë të kontribuojë për punë më cilësore edukative-arsimore të mësimdhënësve dhe të arritura më të larta të nxënësve në Republikën e Maqedonisë.

Projekti filloi të realizohet në dhjetor të vitit 2012 dhe do të zgjasë deri në qershor të vitit 2015.



Projekti për Zhvillim Profesional dhe në Karrierë të Arsimtarëve realizohet me mbështetje të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.

HYRJE

Lexues të nderuar,

Në këtë edicion të tretë të Buletinit vend qendror i është kushtuar përvojave të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkolla nga pilotimi i propozim-zgjidhjeve për zhvillim profesional të përpiluar nga grupet e punës e Projektit. Krahas kësaj do të keni mundësi të lexoni për risitë e vendosura, sistemin për zhvillim profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativo-arsimor në shkolla.

Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit, përmes përpilimit dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore, rregullon një pjesë të zgjidhjeve që kanë rezultuar nga propozimet e grupeve të punës. Me fillimin e vitit shkollor 2015/2016, sipas Ligjit për arsimtarë, arsimtarët tashmë duhet të përpilojnë Plan personal për zhvillim profesional në bazë të Kompetencave themelore profesionale për arsimtarë dhe i identifikojnë nevojat për zhvillim profesional. Gjatë përcaktimit të formës dhe përmbajtjes së planit është marrë parasysh përvoja dhe informacioni kthyes prej rreth 150 arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të 14 shkollave fillore dhe të

mesme që e pilotuan procesin, procedurat, instrumentet dhe Udhëzimin për planifikimin e zhvillimit profesional. Sipas qasjes së re për zhvillim profesional, secili individ në mënyrë sistematike i identifikon nevojat personale dhe e merr përsipër përgjegjësinë



për ndërtimin e mëtejshëm të kompetencave duke shfrytëzuar forma të llojllojshme të nxënies. Kompetencat paraqesin shtyllën e sistemit për zhvillim profesional të kuadrove të përgjithshme edukativo-arsimore dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e kuadrit mësimdhënës. Disa pikëpamje personale të anëtarëve të grupeve të punës të përfshira në përpilimin dhe pilotimin e kompetencave janë paraqitur në këtë numër.

Njëherësh, Projekti bëri një hap të rëndësishëm përpara në ndërlidhjen e zhvillimit profesional të arsimtarëve me procesin për avancim në titull më të lartë. Arsimtarët, prej 23 shkollave fillore dhe të mesme në shtet që e pilotuan procesin për avancim në titull, përpiluan portofola elektronikë që do të shfrytëzohen për testimin e instrumenteve dhe procedurave të përpunuara për vlerësim, me qëllim të vendosjes së sistemit funksional për avancim në karrierë.

Në këtë numër është zhvendosur edhe shqyrtimi i lidhshmërisë së zgjidhjeve të reja nga sistemi për zhvillim profesional dhe në karrierë me përgatitjen e kuadrit të ardhshëm mësimor të fakulteteve për arsimtarë.

Po ashtu, është dhënë një pasqyrë e aktiviteteve të përfunduara gjatë periudhës prej botimit të numrit paraqitës të buletinit.

Shpresojmë se përmbajtja e këtij numri do t'ju informojë dhe do ta tërheqë vëmendjen tuaj.

Me respekt,

Vera Kondiq Mitkovska,
udhëheqëse e projektit



KOMPETENCA PROFESIONALE TË ARSIMTARËVE – PSE U JANË ATO TË RËNDËSISHME ARSIMTARËVE

Duke i ndjekur trendet botërore, viteve të fundit, janë bërë një numër i madh i reformave në sistemin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë, duke synuar që të sigurohen mësim dhe nxënie që do t'i aftësonin nxënësit për jetë në shekullin 21 te ata të zhvillojnë shkathtësi për nxënie të përgjetshme. Ato ndryshime, shpesh, i habitnin arsimtarët, meqë fitohet përshtypje sikur vazhdimisht kërkohet prej tyre diçka e re dhe e ndryshme. Nga ana tjetër, hulumtime të shumta tregojnë se cilësia e mësimit dhe të arriturat e nxënësve në masë të madhe varen nga dituritë, shkathtësitë dhe përkushtimi i arsimtarëve të tyre. Vetëm arsimtari, i cili edhe vetë është i gatshëm të ndryshojë, mund të kontribuojë që te nxënësit të zhvillohen aftësi dhe qëndrime të rëndësishme për nxënien e vazhdueshme. Arsimitimi formal, veçanërisht vetëm arsimimi bazik, më nuk mjafton për të mbajtur hapin me numrin e madh të ndryshimeve dhe të njëjtat të mund të zbatohen me sukses në punën edukativo-arsimore. Prandaj nevojitet zhvillim i vazhdueshëm profesional i arsimtarëve përmes formave të ndryshme dhe arsimim joformal dhe informal.



Të gjithë jemi dakord se për arsimim cilësor pa dyshim nevojitet një arsimtar cilësor? Cilat janë karakteristika e një arsimtari cilësor? Cilat janë ato dituri dhe shkathtësi që duhet t'i posedojë një arsimtar, si duhet të jetë realizimi i mësimit, si duhet të jetë realizimi i mësimit, si duhet të bashkëpunojë me nxënësit, prindërit dhe bashkësinë më të gjerë, sa dhe në çfarë drejtimi duhet të përsoset profesionalisht që të mund të quhet cilësor?

Ndonëse përgjigjet e këtyre pyetjeve janë të domosdoshme që të arrihet cilësia e dëshiruar në arsim, megjithatë deri tani nuk ekzistonte kuptim i njëjtë të nocionit “arsimtar cilësor”, që rezultoi me interpretim të ndryshëm madje edhe nga ana e vetë arsimtarëve, kështu që ata tentojnë ta arrijnë cilësinë, që në mënyrë të pavarur, në njëfarë mënyre, e kanë defnuar, varësisht nga potencialet e tyre të deriatëhershme, përvojat dhe mjedisin në të cilin punojnë. Me këtë rast, secili prej arsimtarëve synon të arrijë përsosje sipas drejtimeve dhe perceptimeve personale për atë se çfarë është arsimtar cilësor, me iniciativë individuale, pa ekzistuar politikë për zhvillim profesional të arsimtarit, si dhe në mungesë të standardeve dhe kriterëve për zhvillim profesional të arsimtarit, si dhe në mungesë të standardeve dhe kriterëve për zhvillim profesional dhe avancim në karrierë.

Në Programin për zhvillim profesional të kuadrit shkollor, i cili është pjesë përbërëse e Programit nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015, potencohet nevoja për zhvillim profesional dhe në karrierë të arsimtarëve, si efekt themelor me të cilin do të motivoheshin të punësuarit në arsim për nxënie të vazhdueshme dhe përsosje profesionale, e me këtë edhe për realizimin e mësimit cilësor dhe rritjen e të arriturave të nxënësve. Por, ndonëse zhvillimi profesional dhe në karrierë është i rregulluar me ligj, deri tani nuk ishte parashikuar me akte dhe procedura nënligjore se si do të realizohet i njëjti.

Për herë të parë me Ligjin për arsimtarë shkollat fillore dhe të mesme, të miratuar në vitin 2015, është rregulluar mënyra e zhvillimit profesional dhe në karrierë të arsimtarëve. Sipas Ligjit, arsimtari për të zhvilluar mësimin duhet t'i posedojë kompetencat themelore profesionale për arsimtar, ndërsa mund të përparojë në tituj arsimtar mentor dhe arsimtar këshilltar, nëse i arrin standardet e parashikuara për titujt e tillë.

Ekzistimi i dokumenteve siç janë Kompetencat themelore profesionale të arsimtarëve dhe Standardet profesionale për arsimtar mentor dhe arsimtar këshilltar është hapi i parë drejt përcaktimit të diturive dhe shkathtësive që duhet t'i posedojë një arsimtar për realizimin e suksesshëm të punës edukativo-arsimore, si dhe për aftësinë e tij për avancim në titull.

Kompetencat profesionale në fakt janë ajo që tashmë një kohë më të gjatë u nevojitej arsimtarëve në Republikën e Maqedonisë – përshkrim i asaj që pritet ta dijë arsimtari dhe të mund ta bëjë, si dhe i vlerave nga të cilat duhet të udhëhiqet në profesionin e vet, gjegjësisht përshkrim i nocionit „arsimtar cilësor”.



Standardet, nga ana tjetër, i përshkruajnë pritjet se çka është ajo që duhet ta posedojë secili arsimtar që të mund të fitojë titullin arsimtar mentor dhe arsimtar këshilltar, gjegjësisht të avancohet në karrierën e vet.

Kompetencat themelore profesionale të arsimtarëve janë dokument i rëndësishëm që pritet të kontribuojë për rregullimin më të mirë të profesionit të arsimtarit. Në to është përcaktuar në mënyrë të hollësishme se çka duhet arsimtari të dijë, të mundet dhe të bëjë për ta realizuar me sukses punën edukativo-arsimore.

Kompetencat janë përkufizuar si përmbledhje e diturisë së përvetësuar, shkathtësive dhe vlerave profesionale, gjegjësisht aftësi të dëshmuar për shfrytëzimin e diturisë dhe shkathtësive në situata të nxënies ose realizimit të punës edukativo-arsimore. Të njëjtat kanë të bëjnë me angazhimet e përgjithshme profesionale të arsimtarëve në punën mësimore dhe jashtëmësimore me nxënësit, kolegët dhe bashkësinë më të gjerë, duke përfshirë dituri, aftësi dhe vlera profesionale të arsimtarit për shekullin 21, në të cilat janë përfshirë edhe kompetencat që janë zhvilluar te arsimtarët në kuadër të projekteve të ndryshme inovative që në 15 vitet e fundit realizohen në Republikën e Maqedonisë. Përmbajnë edhe shembuj të aktiviteteve për praktikën profesionale të arsimtarit, që

PROJEKTI PËR ZHVILLIM PROFESIONAL DHE NË KARRIERË TË ARSIMTARËVE



НАМЕНА НА КОМПЕТЕНЦИИТЕ ЗА НАСТАВНИЦИ

- Планирање на професионалниот развој на сите нивоа;
- Постапување стандарди за повисоките зvaња за наставници (наставник-ментор и наставник-советник);
- Изготвување на процедури и инструменти за следење на работата на наставниците;
- Изготвување компетенции за одделни профили на наставници;
- Подобрување на законската регулатива и актите кои се однесуваат на професијата наставник.

do t'i ndihmojnë arsimtarit gjatë vetëvlerësimit të praktikës mësimore, ndërsa mund t'i shfrytëzojnë edhe subjekte tjera që e përcjellin dhe vlerësojnë punën e arsimtarit.

Ekzistimi dhe shfrytëzimi i kompetencave pritet t'i stimulojë arsimtarët në përmirësimin e praktikës së tyre profesionale dhe do t'i mbështesë aktivitetet për krijimin e mësimin cilësor. Në përputhje me kompetencat e secilit arsimtar do të mund të planifikojë lehtë zhvillimin e vet personal, duke identifikuar se cilat kompetenca i ka arritur, e në përmirësimin e së cilës duhet të punojë. Për këtë qëllim duhet të jetë i aftë ta planifikojë zhvillimin e vet profesional për çdo vit shkollor (në përputhje me Ligjin për arsimtarë në shkollat fillore dhe të mesme). Planifikimi i zhvillimit profesional kryesisht mbështetet në vetëvlerësimin në raport me kompetencat profesionale përmes të cilit secili individ i identifikon anët e tij të fuqishme, aspiratat profesionale dhe do të planifikojë se si t'i arrijë të njëjtat.

Standardet për arsimtar mentor dhe arsimtar këshilltar paraqesin kornizë për zhvillimin në karrierë të arsimtarëve dhe sqarojnë se cilat kompetenca duhet t'i ketë të zhvilluara arsimtari për t'u avancuar në titull. Këto kontribuojnë në profesionalizimin dhe

ngritjen e statusit të profesionit të arsimtarit. Për të arritur, një shkallë të caktuar të zhvillimit të arsimtarëve në karrierë, arsimtarët do të duhej të demonstrojnë arritje të disa kompetencave të caktuara. Standardet paraqesin një kornizë e cila qartazi e përshkruan diturinë, punën praktike dhe angazhimin profesional të arsimtarëve në nivele të ndryshme të karrierës. Duke i shfrytëzuar standardet, arsimtarët vetë do të mund të identifikojnë se deri në çfarë niveli të zhvillimit në karrierë kanë arritur dhe çfarë duhet ende të bëjnë për t'i arritur kërkesat për avancim në titullin e radhës.

Nëse merret parasysh fakti se Katalogu i kompetencave themelore profesionale është përpiluar në vitin 2014, ndërsa Ligji për arsimtarë në shkollë fillore dhe të mesme është përpiluar në vitin 2015, është evidente se jemi në fillim të udhëtimit të quajtur zhvillim cilësor profesional të arsimtarëve dhe avancim të tyre na karrierë. Megjithatë, me përpilimin e kompetencave themelore profesionale dhe standardeve për përparim janë vendosur bazat për mirëkuptim më të mirë dhe të njëtrajtshëm për atë se çfarë duhet arsimtarët të arrijnë që të jenë arsimtarë cilësorë, si të bëjnë vetëvlerësimin, si të përsosen në aspektin profesional, cilat kompetenca duhet t'i arrijnë për t'u avancuar. Kompetencat ofrojnë përshkrim preciz dhe konkret drejt cilës mënyrë të punës duhet të synojnë përfaqësuesit për të siguruar mësim më cilësor dhe të arritura më të mira tek nxënësit.

Që të mund të mirëmbahet hapi me të gjitha ndryshimet dhe të sigurohet mësim cilësor nevojiten arsimtarë të edukuar mirë dhe të shkathët, të cilët në vazhdimësi zhvillohen dhe përsosen në aspektin profesional, ndërsa kompetencat profesionale dhe standardet për arsimtarë janë udhërrëfyes i mirë në këtë rrugë.

Maja Videnoviq,
mësimdhënëse, Sh.F. „Krste Misirkov”, Skopje

KOMPETENCA DHE STANDARDE PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL – NGA KËNDI PERSONAL

Në shkollat, si pjesë e kuadrit edukativo-arsimor, përveç arsimtarëve, punojnë edhe bashkëpunëtorët profesional. Përfshirja e tyre në sistemin shkollor para më shumë viteve filloi me punësime të pedagogut ose psikologut në shkolla, e në raste të rralla edhe të dy profileve në shkollë të njëjtë, që sot në shkollat të funksionojnë ekipet të stafit të bashkëpunëtorëve profesional (psikolog, pedagog, defektolog, diku edhe sociolog, bashkëpunëtor social...).

Viteve të fundit shpesh nuk ishte saktësisht e dalluar se çka është ajo që punëtorët profesionalë e punojnë, ndërsa shpesh edhe vetë nuk e dimë në çka të fokusohemi: në punën individuale me nxënës ose në aktivitete për përmirësimin e gjithë shkollës. Sot, në shumicën e shkollave, bashkëpunëtori profesional dallohet si dikush që është i udhëzuar mirë dhe i përfshirë

në punën e përgjithshme të shkollës – organizimin, zhvillimin dhe evalvimin e saj, si dhe krijimin e politikave dhe programeve të saj dhe si iniciator i qasjeve inovative në punën e përgjithshme edukativo-arsimore. Bashkëpunëtorët profesional kanë pozicion kryesor në ndërlidhen e sektorit mental, edukativ dhe social në kushtet e shkollës. Puna jonë nuk ndalet vetëm në nivel të klasës, por zhvillohet në nivel të shkollës; jo vetëm me një numër të caktuar të nxënësve, por me të gjithë nxënësit, prindërit dhe arsimtarët dhe përfshinë parandalim, këshillim, evalvim, intervenim, edukim dhe hulumtim. Një pjesë e punës sonë është analiza e situatave në shkollë, por edhe në përgjithësi në sistemin arsimor, hulumtim dhe propozim i zgjidhjeve të mundshme.

Pikërisht për këtë arsye, paralelisht me përpilimin e Kompetencave themelore profesionale për arsimtarët, ishte me rëndësi të përpilohet një dokument i ngjashëm edhe për bashkëpunëtorët profesionalë. Rëndësia e Kompetencave themelore profesionale qëndron në atë se ato më në fund e paraqitën rolin e bashkëpunëtorëve profesional në shkolla, që t'i jetë më e qartë kuadrit tjetër edukativo-arsimor, e në linjë të fundit edhe të gjithë shfrytëzuesve të shërbimeve tona. Por, nga ana tjetër edhe i orientojnë bashkëpunëtorët profesionalë drejt asaj

që duhet ta posedojnë si dituri dhe shkathtësi që të mund të jenë cilësore në punën e tyre dhe si t'i zhvillojnë dhe avancojnë këto dituri dhe shkathtësi.

Me Kompetencat themelore profesionale janë përfshirë fushat në kuadër të të cilave zhvillohet puna e bashkëpunëtorëve profesional: punë me nxënës, punë me arsimtarë, punë me prindër, punë me bashkësinë, zhvillim profesional dhe bashkëpunim profesional, punë analitike hulumtuese dhe organizim, kulturë dhe klimë shkollore. Ndonëse puna në të gjitha profilet e bashkëpunëtorëve profesional zhvillohet në kuadër të këtyre fushave, secili profil ka specifikat e veta. Me rëndësi te këto kompetenca është ajo se ato specifika dallohen dhe pritet të shfrytëzohen në situata të caktuara. Megjithatë theksohet rëndësia e punës ekipore, me çka kompeten-



PROJEKTI PËR ZHVILLIM PROFESIONAL DHE NË KARRIERË TË ARSIMTARËVE



cat e profileve të ndryshme do të vihen në funksion të kontributit optimal drejt ndërtimit të shkollës që do të jetë mjedis i këndshëm dhe stimulues për të gjithë.

Duke marrë parasysh faktin që bashkëpunëtorët profesional janë ata që duhet me dituri të dhe shkathtësitë e veta, por edhe me shembullin e vet të kontribuojnë për klimën dhe kulturën e shkollave, konsideroj se janë me rëndësi të veçantë vlerat që janë përshkruar dhe prej të cilave duhet të udhëhiqet çdo bashkëpunëtor profesional në punën e vet. Kjo do të kontribuojë për respekt dhe integritet më të madh të bashkëpunëtorit profesional.

Kompetencat themelore profesionale janë të rëndësishme për disa aspekte:

- bashkëpunëtorëve profesional, veçanërisht atyre më të rinjve, do t'u ndihmojnë në planifikimin e punës personale dhe të zhvillimit personal profesional dhe në karrierë,
- për opinionin, kompetencat do të thonë burim të informimit dhe dallimit të rolit të bashkëpunëtorëve profesional në shkollat,
- në planin profesional, kompetencat paraqesin bazë për vendosjen e standardeve për tituj më të lartë të bashkëpunëtorëve profesional (bashkëpunëtor profesional mentor dhe bashkëpunëtor profesional këshilltar).

Për të gjithë bashkëpunëtorët profesional, por, në këtë moment,

veçanërisht për ata që në zhvillimin profesional kanë arritur nivel më të lartë, në interes të veçantë është ajo se janë përpiluar edhe Standarde për tituj bashkëpunëtor profesional – mentor dhe bashkëpunëtor profesional - këshilltar. Në fakt, standardet tregojnë se në çfarë drejtimi duhet të rrjedhë zhvillimi profesional i bashkëpunëtorëve profesional dhe cilat kompetenca ata duhet t'i kenë të zhvilluara që të përparojnë në karrierën e tyre. Më në fund, ata që me punën e tyre kontribuonin për zhvillimin profesional të kolegëve të tyre arsimtarë, për zhvillimin e profesionit dhe shkollës në tërësi, patën rastin që edhe vetë të avancohen në aspektin profesional dhe në karrierë. Standardet e verifikojnë punën e bashkëpunëtorëve profesionalë, të cilët janë të përfshirë në të gjitha proceset dhe ndryshimet më të rëndësishme edhe në nivel shkollor edhe në atë shtetëror dhe kontribuojnë në mënyrë aktive për avancimin e arsimit në përgjithësi.

Ai që e do profesionin e vet me siguri e di se çfarë duhet të punojë, di ta punojë atë dhe të njëjtën e përsosë dhe avancohet vazhdimisht. Por, dokumentet siç janë Kompetencat themelore profesionale dhe Standardet për tituj më të lartë të bashkëpunëtorëve profesional dhe Standarde për tituj më të lartë të bashkëpunëtorëve profesional gjithsesi do të na jenë udhërrëfyes i mirë.

Andrijana Tasevska,
psikologe,
Sh.F. „Krume Kepeski”, Skopje

PËR HERË TË PARË TE NE – KOMPETENCA PROFESIONALE PËR DREJTORË

Pozicioni i drejtorit në shkollat fillore gjithnjë e më shumë rregullohet dhe bëhet më profesional. Në këtë kontekst në kuadër të Projektit për zhvillim profesional dhe në karrierë të arsimtarëve, e në bashkëpunim me Qendrën Shtetërore të Provimeve, përgjegjëse për trajnimin dhe provimin për drejtorë, u përpiluan Kompetenca profesionale për drejtorë.

Kandidatët për drejtorë në shkollat fillore dhe të mesme, krahas kushteve tjera, duhet të ndjekin dhe realizojnë trajnim dhe të japin provim për drejtorë. Trajnimet janë rregulluar me Rregulloren për trajnime dhe provim të drejtorëve, ndërsa prej vitit 2016 do të fillojë të zbatohet Ligji i ri për trajnime për drejtorë. Rregullimi i kësaj materie me ligj, obligon që të bëhet revidimi i programit për trajnim të drejtorëve, si dhe të përpilohet program për trajnim të avancuar të drejtorëve aktualë që do të jetë në funksion të zhvillimit të tyre të vazhdueshëm profesional. Nga këtu rezultoi edhe nevoja për përpilimin e dokumentit në të cilin, në përputhje me kompleksitetin e rritur të pozicionit drejtor i shkollës, do të përcaktohen qartazi kompetencat e nevojshme për realizimin e suksesshëm të këtij funksioni.

Grupi punues i përbërë prej drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme, profesorë universitarë, përfaqësues të MASH-it dhe QSHP-së, si dhe persona tjerë profesionalë nëpër takime dhe konsultime të shumta përpiloi Projekt kompetenca profesionale për drejtorë. Gjatë punës, grupi i kishte parasysh dokumentet e ngjashme nga vendet tjera, si dhe kompetencat tashmë të përpiluara për arsimtarë dhe bashkëpunëtorë profesional në vendin tonë.

Projekt-kompetencat ishin objekt i diskutimit në tavolinën e punës në të cilën ishin ftuar për të marrë pjesë një rreth më i gjerë i përfaqësuesve të bashkësisë profesionale edhe atë: drejtorë, përfaqësues të

Ministritë së Arsimit dhe Shkencës, Qendrës Shtetërore të Provimeve, Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, Bankës Botërore, shkollës private NOVA, USAID-it, përfaqësues të fakulteteve, inspektor i autorizuar arsimor nga komuna, etj. Po ashtu, u organizua debat publik dhe Projekt kompetencat profesionale iu dërguan të gjithë drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme, ndërsa mendimin e tyre e dhanë 50 drejtorë aktual. Me qasjen e këtyllë gjatë përgatitjes së dokumentit, u mundësua që në mënyrë transparente të përfshihen të gjitha palët e prekura. Mendimet dhe sugjerimet e fituara janë marrë parasysh në procesin e finalizimit të dokumentit.



Dituritë dhe kuptimet profesionale, aftësi dhe shkathtësi, si dhe shembuj të aktiviteteve të mundshme janë përfshirë në fushat vijuese të punës së drejtorëve: Lidership; Udhëheqje e resurseve njerëzore; Udhëheqje pedagogjike e shkollës; Udhëheqje financiare; dhe Punë ligjore dhe administrative e shkollës. Këto kompetenca kanë të bëjnë me jetën e përgjithshme të shkollës, si në shkollë ashtu edhe jashtë saj.

Me ndikimin e vet thelbësor të programeve për trajnimin themelor dhe të avancuar për drejtor, dokumenti hyn në sistemin për përgatitje të drejtorëve, ashtu edhe në sistemin për zhvillim të tyre të vazhdueshëm profesional.

Voleta Naumovska,
udhëheqëse e sektorit,
Qendra Shtetërore e Provimeve

РЕФЛЕКСИИ НА КОМПЕТЕНЦИИТЕ ЗА ПРОФЕСИОНАЛЕН И КАРИЕРЕН РАЗВОЈ НА НАСТАВНИЦИТЕ ВРЗ ИНИЦИЈАЛНОТО ОБРАЗОВАНИЕ НА НАСТАВНИЦИТЕ

Arsimi inicial i arsimtarëve “ende” paraqet kusht fillestar dhe të vetëm për vendosjen e profesionit të arsimtarit¹. Kjo është pjesë përbërëse e nënsistemit të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë dhe i njëjti prodhon kuadro mësimdhënëse për edukim parashkollor, arsim fillor dhe të mesëm. Si i tillë, sistemi i arsimimit inicial të kuadrove mësimdhënëse u nënshtrohet ndikimeve ligjore, zgjidhjeve të reja institucionale, ndikimeve të të arriturave tekniko-teknologjike dhe nevojave të familjes bashkëkohore dhe fëmijës/nxënësit të sotëm.

Kuptohet se ndryshime të rëndësishme ndaj sistemit të edukimit inicial të arsimtarëve priten edhe pas përcaktimit dhe miratimit të kompetencave themelore profesionale të arsimtarëve që janë produkt i aktiviteteve të projektit në kuadër të *Projektit të USAID-it për zhvillim profesional dhe në karrierë të arsimtarëve*. Me këtë rast do të veçonim disa supozime për ndikime të mundshme ndaj përkushtimit aktual të edukimit inicial të arsimtarëve.

- **Përgatitje e mbështetur në kompetenca (Competence based learning) në vend të Përgatitje e orientuar drejt procesit (Process oriented learning).** Arsimimi i tanishëm inicial i arsimtarëve është fokusuar në suksesin gjatë realizimit të procesit të përshtatjes së arsimtarëve, kohëzgjatjes së pjesës teorike dhe praktike të arsimimit të arsimtarëve, respektimin e standardeve dhe parimeve ECTS etj., i njëjti orientohet drejt organizimit në bazë të parimit të zhvillimit të kompetencave të arsimtarëve (të strukturuar dhe organizuar në nivel të lartë) që më tutje do t'i nënshtroheshin zhvillimit plotësues përmes formave tjera të mësimit të vazhdueshëm profesional.
- **Profesionalizim i profesionit të arsimtarit në vend të personalizimit të programeve të lëndëve për arsimim inicial.** Krijohen kushte, zgjidhje të caktuara personale, që rezultojnë nga hasja e mësimdhënësve universitarë të angazhuar në arsimimin inicial të arsimtarëve dhe pozicionim të mirë të strukturave udhëheqëse, të zëvendësohen me kuadro që do të realizojnë programe të lëndëve në përputhje me kompetencat e arsimtarëve dhe nevojat e profesionit të arsimtarit.
- **Qasje e dispersuar në mënyrë të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe e thelluar në mënyrë të njëjtë drejt zhvillimit të kompetencave të arsimtarëve në vend të përzgjedhjes selektive, të favorizuar dhe dominuese të kompetencave që zhvillohen në institucionet për arsimim inicial të arsimtarëve.**

¹ D. Iliev. (2001). Arsimimi inicial i arsimtarëve të arsimit fillor në Maqedoni dhe Angli, Manastir: Fakulteti për mësues dhe edukatorë Manastir



tarëve. Në shtrirjen aktuale programore të arsimit inicial të arsimtarëve ekzistojnë dallime në programet studimore për arsimim inicial të arsimtarëve që tregojnë se disa institucione më shumë e vënë theksin në zhvillimin e kompetencave për fushën njohje të lëndës ose bazat substrate të mësimi për një lëndë të caktuar, derisa të tjerët theksin në programet studimore e vënë në fushën mësimdhënie dhe nxënie. Fatkeqësisht, është i vogël numri i institucioneve për arsimim inicial të arsimtarëve në të cilat vend të konsiderueshëm marrin kompetencat në fushat zhvillim profesional dhe bashkëpunim profesional, si dhe fusha inkluzion social dhe arsimor. Katalogu i kompetencave profesionale të arsimtarëve mund ta ndryshojë këtë gjendje shpërndarjen e barabartë të programeve lëndore në drejtim të zhvillimit inicial të të gjitha kompetencave të përmendura të arsimtarëve.



- Në vend të profesionit të zhvilluar të diturive teorike, arsimim inicial i fokusuar në veprime të dukshme dhe matëse. Ekziston mundësia që një pjesë e madhe e programeve lëndore në fakultetet e arsimtarëve në pjesën e aktiviteteve dhe ushtrimeve praktike të realizohen në drejtim të dizajnit, prodhimit dhe realizimit të kategorisë “Aktivitete” të zhvendosur në strukturën kompetenca profesionale të arsimtarëve, ku në mënyrë të hollësishme janë përshkruar kompetencat përmes, për ta, deskriptorëve përkatës.
- Nën ndikimin e kompetencave të përcaktuara fillore profesionale të arsimtarëve fushë e interesit e institucioneve për arsimim inicial të arsimtarëve bëhet zhvillimi profesional dhe në karrierë i arsimtarëve. Me fjalë tjera, përshkrimi i kompetencave siguron vetëdije të arsimtarëve për posedimin ose posedimin e pamjaftueshëm të kompetencave të përmendura, gjë që inicion përfshirje në procesin e zhvillimit permanent profesional. Këtu është shansi për fakultetet e arsimtarëve që duhet ta shfrytëzojnë përmes dizajnit të trajnimeve, akreditimit të të njëjtave dhe punë aktive me arsimtarët. Për këtë qëllim, krahas programeve lëndore për arsimim inicial, nevojitet dizajnim i programeve për plotësimin e diturive lidhur me kompetencat, gjegjësisht programe për kurse të avancuar për zhvillim në karrierë të arsimtarëve.
- Ekzistimi i katalogut të kompetencave profesionale të arsimtarëve e inicion, por edhe përshkruan dhe definojnë nevojën e përcaktimit të kompetencave unike të arsimtarëve që duhet t’i posedojë secili që dëshiron të merret me profesionin e arsimtarit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për rishqyrtimin e formatit të realizimit të kualifikimit plotësues pedagogjik, përfaqësimit të kompetencave profesionale të arsimtarëve në programet studimore dhe lëndore të fakulteteve për arsimtarë, për arsimtarët lëndorë, etj.

Këto janë vetëm disa nga ndikimet e supozuara sekondare të Projektit të USAID-it për zhvillim profesional dhe në karrierë të arsimtarëve ndaj sistemit dhe institucioneve për arsim inicial të arsimtarëve në Republikën e Maqedonisë.

prof. d-r. Dean Iliev,

Universiteti „Shën Kliment Ohridski”, Fakulteti pedagogjik - Manastir

PILOTIMI I PROCESIVE DHE INSTRUMENTEVE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL NË SHFK “MANÇU MATAK” - KRIVOGASHTAN

Shkolla jonë ishte një nga 14 shkollat fillore dhe të mesme në Maqedoni që i pilotonin proceset dhe instrumentet për zhvillim profesional në përputhje me Udhëzimin për këtë dedikim. Ky ishte një nder i posaçëm, por edhe obligim për arsimtarët dhe pedagogët tanë.

Që në takimin e parë të fokusit me këshilltaren Natalija Aceska nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) dhe pa e ditur se çfarë na pret u paraqitën një numër i madh i arsimtarëve për të marrë pjesë në pilotimin (12 arsimtarë ose 40% e arsimtarëve të punësuar në shkollë, pedagogu dhe drejtori).

Asnjëherë deri tani nuk kemi pasur rastin të marrim pjesë në pilotimin e diçkaje që është aq e rëndësishme për punën tonë, (zakonisht gjithçka që vendoset është tashmë gati e dhënë), ndaj ndjenja e domethënies dhe rëndësisë që u është kushtuar arsimtarëve që patën rastin të japin kontributin e vet maksimal gjatë pilotimit.

Gjatë pilotimit, ishin simuluar të gjitha proceset dhe instrumentet e parashikuara, ndaj kjo rezultoi me një numër ët madh të propozimeve nga ana jonë, diskutime të gjata, kontribut konstruktiv për përmirësimin e vetë udhëzimit, po madhe edhe gjetje të disa lëshimeve.

Gjatë pilotimit me arsimtarët nën koordinimin e pedagogut u realizuan disa takime si bashkësi për nxënie në të cilat sqaroheshin proceset nga Udhëzimi, bashkërisht plotësoheshin një pjesë e instrumenteve, vëreheshin pro-

pozimet, korrigohej diçka që mendojmë se ishte e nevojshme. Kjo mënyrë e punës për ne ishte diçka e panjohur – edhe më parë vazhdimisht punonim si bashkësi për nxënie.

Sfidë më të madhe për të gjithë arsimtarët ishte plotësimi i planit personal për zhvillim profesional, mënyrën në të cilën duhej t'i definojnë kompetencat e veta si prioritete, si dhe sfidën që të njëjtët të realizohen në kushte të tanishme. Prandaj, prej këtu propozimi për të ulur numrin e kompetencave dhe/ose saktësisht të kufizohet, që më pas ishte marrë parasysh gjatë versionin përfundimtar.

Gjatë simulimit të takimit të Ekipit për zhvillim profesional në shkollë u shqyrtua se na nevojitet instrument plotësues me të cilin do t'i përkufizojmë kompetencat si prioritete në përputhje me planet personale për zhvillim profesional të arsimtarëve, ndaj edhe këtë e propozuam edhe si mundësi edhe si format të formularit.

Sa i përket, nga ana tjetër, vetëm procesit të pilotimit që e kaluam, të gjithë arsimtarët konsiderojnë se është shumë ngjashëm me atë se si punohet zakonisht në shkollën tonë, gjithsesi me disa instrumente/formularë të reja, veçanërisht planin personal për zhvillim profesional, meqë deri tani prioritetet i kemi përcaktuar në nivel të shkollës përmes pyetësorëve nga arsimtarët.

Numri më i madh i arsimtarëve janë dakord se Udhëzimi për planifikimin e zhvillimit profesional është i

kuptueshëm, dhe se instrumentet dhe procedurat e rekomanduara janë të dobishme, me ndryshime dhe shtesa të vogla.

Pas kësaj përvoje që e kemi në shkollën tonë, e më pas edhe pas pilotimit të zhvillimit në karrierë mund të konstatojmë se:

- procesi i këtillë i pilotimit është i dobishëm dhe duhet të jetë i obligueshëm për çdo program të ri, reformë dhe/ose risi në procesin edukativo-arsimor;
- një pjesë e madhe kolektivit tonë është mjaft kompetent për të dhënë kontributin e vet që të pilotohet një proces i këtillë i rëndësishëm;
- praktika e bashkëpunimit dhe punës në bashkësi për nxënie u tregua e dobishme dhe produktive edhe për mënyrën e këtillë të punës;
- nevojitet koordinim dhe udhëzim nga dikush në shkollë, ndërsa më të udhëzuar dhe më kompetentë për këtë janë bashkëpunëtorët profesionalë;
- gjatë procesit të këtillë nevojitet mbështetje edhe nga kuadri udhëheqës në shkollë, si edhe nga kreatorët e risive.

Ubavka Butleska,
pedagoge, Sh.F. „Mançu Matak“,
Krivogashtan, Prilep

